



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 4022 Prot.

Tiranë, më 17.11 2021

VENDIM

Nr. 14, datë 11.11.2021

**MBI SHTYRJEN E DALJES NË PENSION PËR PERSONELIN AKADEMIK ME
KOHË TË PLOTË, KATEGORIA “PROFESOR”, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 40, pika 3, të nenit 65, pika 1 dhe 2, të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të nenit 70, pika 1 dhe 2, të Statutit të UT-së; për të siguruar vazhdimësinë dhe zhvillimin afatgjatë të njësive bazë, si edhe të çdo njësie tjetër të Universitetit të Tiranës, si një nga qëllimet dhe politikat e UT-së, Rektorati i UT-së, si organi kolegjal që ka për kompetencë të hartojë planin strategjik të institucionit, në mbledhjen e tij, të datës 11.11.2021,

VENDOSI:

1. Personelit akademik me kohë të plotë të kategorisë “Profesor”, pas plotësimit të moshës të daljes në pension, sipas përcaktimeve në nenin 65, pika 1 dhe 2, të ligjit nr.80/2015 të arsimit të lartë, si dhe kërkesave të nenit 70, të Statutit të UT-së, si rregull, mund t’i shtyhet deri në 1(një) herë kontrata e punës me UT, me afat të caktuar 1 (një) vjeçar.
2. Në raste të veçanta, sipas nevojave institucionale dhe për personalitete të shquara të personelit akademik me kohë të plotë, brenda përcaktimeve të nenit 65, të ligjit nr.80/2015 të arsimit të lartë, dhe kërkesave të nenit 70, të Statutit të UT-së, mund të ketë përjashtime nga ky rregull.
3. Ky Vendim përcillet për njohje dhe zbatim në të gjitha njësitë përbërëse të Universitetit të Tiranës.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Artan Hoxha